



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

BA 2013/01

KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA

RREGULLORE

E PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA

Prishtinë, 15 prill 2013

Bordi për Ankesa:

Në mbështetje të nenit 42, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve (Ligjit për KPM-në), me qëllim të përcaktimit të rregullave të organizimit, procedurave të punës dhe të funksionimit të Bordit për Ankesa,

Miraton këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA

NENI 1: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kjo rregullore pune përcakton organizimin, procedurat e punës dhe të funksionimit të Bordit.

NENI 2: PËRKUFIZIMET

Komisioni i Pavarur për Media: organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele.

Bordi për Ankesa: organ i pavarur kompetent për shqyrtimin e ankesave të palëve ndaj vendimeve të KPM-së.

Zyra Ekzekutive: organ i Komisionit të Pavarur për Media kompetent për zbatimin e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga KPM-ja brenda kompetencave ligjore të përcaktuara në pajtim me Ligjin e KPM-së.

NENI 3: FILLIMI I PUNËS SË BORDIT

Kryetari i Bordit për Ankesa, në bashkëpunim me Zyrën Ekzekutive, thërret takimet e Bordit për Ankesa.

NENI 4: DORËZIMI I ANKESAVE

1. Ankesat dhe të gjitha dokumentet mbështetëse dorëzohen brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit. Në ankesë duhet të cekët numri dhe data e vendimit të KPM-së të cilit i

referohet ankesa. Ankesa e drejtar Bordit për Ankesa duhet të dorëzohet nëpërmjet zyrës së KPM-së.

2. Pala Ankuese mund të paraqesë ndonjë fakt ose argument ligjor që nuk është shqyrtuar më parë nga Komisioni gjatë marrjes së vendimit. Në Ankesë duhet të specifikohet kundërshtimi i një apo më shumë aspekteve të vendimit të Komisionit si në vijim:

- a) faktet e reja,
- b) interpretimi i gabuar i ligjit,
- c) shkelja e rregullave të procedurës dhe
- d) sanksioni apo kushti i vendosur.

2.1 Pala Ankuese duhet gjithashtu të parashtroj propozim konkret se çka kërkon nga Bordi për Ankesa.

2.2 Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante, apo të bazuara në mundësin se ekziston gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

3. Komisioni duhet të përgatit përgjigje ndaj Ankesës, së bashku me çfarëdo dokumenti mbështetës që KPM-ja e konsideron si të arsyeshme. Komisioni do t'ia dorëzojë këtë përgjigje Bordit për Ankesa jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para seancës së shqyrtimit. Përgjigja në Ankesë do të jetë në dispozicion edhe të Palës Ankuese jo më vonë se tetë (8) ditë para seancës së Bordit për Ankesa, në të cilën Bordi për Ankesa do të shqyrtojë Ankesën. Pala Ankuese nuk ka të drejtë të dorëzojë ndonjë kundërshtim të mëtejshëm me shkrim, por mund të përgjigjet para Bordit për Ankesa gjatë seancës së shqyrtimit.
4. Kur paraqiten ankesat kundër vendimeve të KPM-së, Bordi i Ankesave duhet të njoftohet nga shërbimi profesional administrativ i Zyrës Ekzekutive brenda tri (3) ditëve dhe të dërgohet një kopje e Ankesës.

NENI 5: PROVAT DHE SHKRESAT

1. Barra e paraqitjes së fakteve mbi të cilat mbështetet ankesa do të bie mbi palën ankuese.
2. Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së mund t'i ofrojë Palës Ankuese qasje, në bazë të kërkesës, në të gjitha dokumentet në dosjen e rastit të KPM-së.
3. Ankesa do të dorëzohet dhe nënshkruhet nga Pala Ankuese në gjuhën zyrtare. Ankesës mund t'i bashkëngjitet dokumentacioni mbështetës.
4. Me kërkesën e parashtruar, Bordi për Ankesa mund të pranojë dokumente me shkrim nga palët e treta të cilat kanë interes në proces. Në raste të veçanta, Bordi për Ankesa mund të ftojë palën e tretë që të paraqitet para Bordit për Ankesa.

- Palët e interesuara duhet të kërkojnë nga Bordi për Ankesa leje për prezantim në seanca.

NENI 6: DELEGIMI I DETYRAVE TEK ZYRA EKZEKUTIVE

- Bordi për Ankesa mund t'i delegojë Zyrës së Shefit Ekzekutiv rishqyrtimin e kritereve lidhur me pranimin e Ankesave të cekura në pikën 1 dhe 2 të rregullit 5, si dhe lidhur me saktësinë e provave. Zbatimi i detyrave të deleguara do të mbikëqyret nga ana e Bordit.

NENI 7: SEANCAT DHE GJUHËT

- Zyra e Shefit Ekzekutiv e KPM-së do ta njoftojë Palën Ankuese, jo më vonë se tetë (8) ditë para mbajtjes së seancës shqyrtuese nga ana e Bordit për Ankesa.
- Në qoftë së Pala Ankuese nuk paraqitet në seancën për shqyrtim, Bordi për Ankesa mund ta shqyrtojë Ankesën në seancë duke u bazuar në shkresat e dorëzuara.
- Bordi për Ankesa pas konsultimit më palët mund të vendos për lejimin e pjesëmarrjes se vëzhguesve në seanca.
- Seancat shqyrtuese do të mbahen në gjuhët zyrtare me përkthim simultant apo të vazhdueshëm, sipas nevojës.

NENI 8: PALËT NË SEANCË

- Pala Ankuese dhe Komisioni kanë të drejtë të jenë prezent në seancë shqyrtimi.
- Pala Ankuese mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar.
- KPM përfaqësohet nga anëtarët e Komisionit të KPM-së ose nga përfaqësuesi i autorizuar.

NENI 9: ORGANIZIMI I SEANCËS

- Kryetari i Bordit për Ankesa do të caktoj rrjedhën e seancës.
- Cilido anëtar i Bordit për Ankesa mund të parashtrojë pyetje apo të kërkojë komente nga Pala Ankuese apo Komisioni lidhur me çfarëdo çështje ligjore ose faktike që ka të bëjë me procesin.
- Bordi për Ankesa mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje, që parashtrohet nga cilado palë, gjatë procesit.
- Bordi për Ankesa, sipas vendimit të vet apo sipas kërkesës së cilës do palë, mund të shtyej seancën për aq kohë sa konsiderohet e nevojshme.
- Bordi mund të marrë vendime të nevojshme për të udhëhequr procesin para tij në mënyrë të rregullt dhe më kohë.

NENI 10: VENDIMET E BORDIT

1. Vendimet e Bordit për Ankesa do të merren me shumicë votash.
2. Vendimi i Bordit për Ankesa do të jetë me shkrim dhe do të jetë i arsyetuar. Një anëtar i Bordit për Ankesa mund të shprehë mendim të pavarur ose kundërshtues.
3. Bordi për Ankesa me vendimin e tij mund të miratojë, ndryshojë ose anulojë vendimin e shqiptuar nga Komisioni. Arsyetimi i vendimit do të përbajë konkluzionet e Bordit për Ankesa për faktet materiale, konkluzionet bazuar në ligjin në fuqi dhe vendimin e tij mbi aplikimin e ligjit në faktet e gjetura, duke pasur parasysh lirinë e gjykimit.
4. Procesverbali i votimit do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Bordit për Ankesa, si një dokument i brendshëm i Bordit për Ankesa. Anëtari që është kundër mund ta shënoj votën e tij kundër. Vendimi i Bordit për Ankesa, me arsyetimin e plotë, duhet të lëshohet si një dokument tjeter i nënshkruar nga kryetari i Bordit për Ankesa.
5. Vendimet e Bordit për Ankesa janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural në gjykatën kompetente në pajtim më ligjin në fuqi.
6. Vendimi do t'i dorëzohet palëve në gjuhën e tyre, dhe do të bëhet publik në gjuhët zyrtare. Të gjitha vendimet e Bordit për Ankesa do të publikohen në web-faqen e KPM-së.

NENI 11: HYRJA NË FUQI

Rregullorja e punës së Bordit për Ankesa hyn në fuqi në ditën kur miratohet nga Bordi për Ankesa.



Kryetari i Bordit për Ankesa

Diputat KRAMNIQI